



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

ZL.Anr.296/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Ymer Hoxha anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP), dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), dega në Prizren, për shkak të nxitjes dhe urrejtjes gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 23.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa e Arif Butuç, në cilësinë e kryetarit të subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP), dega në Prizren, e cila identifikohet me shenjë ZL.Anr.296/2017 e datës 21.10.2017, me të cilën ka pretenduar se , Sefki Ozen nga subjekti politik KDTP ka nxitur urrejtje dhe provokime, gjatë periudhës së Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

## A r s y e t i m

Arif Butuç, kryetar i subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP), dega në Prizren, ka paraqitur ankesë në PZAP me datë 21.10.2017, me të cilën ka pretenduar se , me datë 20 tetor ne ora 20 e 30, Sefki Ozen, i ardhur nga Bursa në Mamushë për zgjedhje për të përkrahur subjektin politik KDTP, ka parkuar autobusët para shtëpis së tij dhe ka provokuar familjen e tij duke e kërcënuar dhe fyer. Për këtë rast parashtresuesi i ankesës thotë se është njoftuar edhe KKZ në Mamushë. Andaj thekson se këtë ankesë e paraqet për shkak të nxitjes së urrejtjes, provokimit dhe shqetësimit tek anëtarët e familjes.

Në përgjigje në ankesë të datës 23.10.2017, subjekti politik KDTP, deklaroi se pretendimet e kryetarit të KTAP-së, Arif Butuç janë të pabaza sepse atë ditë është zhvilluar fushata e KDTP-së në Mamushë sipas procedurave dhe paralajmërimeve në KQZ dhe Polici dhe në raportet nga policia nuk ka pasur vërejtje për mbarëvajtjen e fushatës.

Paneli, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore se Sefki Ozen nga subjekti politik KDTP, në Prizren, ka nxitur urrejtje dhe ka fyer familjen e kryetarit të subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP), Paneli i vlerësoi si të paqëndrueshme, andaj pretendimet e kësaj natyre i refuzoi në mungesë të dëshmive të qarta dhe bindëse, ngase parashtruesi i ankesës pretendimet e tij nuk i ka argumentuar me asnjë provë apo nuk e ka udhëzuar Panelin se ku mund të gjenden të njëjtat siç përcaktohet me nenin 5.7 të Rregullave dhe procedurave të PZAP-it.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 115, nenin 117 dhe nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.Anr. 296/2017 me datë 23.10.2017.



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.***